

Osmani takon
nënpresidentin Vance,
shpreh mirënjohje për
aleancën me ShBA-në



FAÇE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"




ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DUKE U BAZUAR NË VOTAT E RREGULLTA TË NUMËRUARA DERI NË MËNGJESIN E 11 SHKURTIT, KËSHTU PRITET TË SHPËRNDAHEN VENDET NË KUVENDIN E KOSOVËS

LV-ja 47 DEPUTETË, PDK-ja 25, LDK-ja 20 DHE AAK-ja 8

FAÇE 4-5



Përfaqësuesi i koalicionit të organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim, Eugen Cakolli, ka thënë se tashmë që rezultatet e vendvotimeve të

rregullta në Kosovë pothuajse janë përfundimtare, ndarja e mandateve në Kuvendin e Kosovës për partitë shqiptare është kjo: LV-ja 47 deputetë, PDK-ja 25 deputetë, LDK-ja 20

deputetë dhe AAK-ja 8 deputetë. Ai ka thënë se votat e partive që nuk e kalojnë pragun as nuk shpërndahen e as nuk i shtohen ndonjë partie tjetër

KOSOVA ME 44 PIKË NË INDEKsin E KORRUPTIONIT

F.7



SHTUNI: JEMI NË NJË FAZË PROBLEMATIKE TË MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SHBA

F.6

Adrian Shtuni, ekspert për politikë të jashtme dhe siguri që vepron në Uashington, ka theksuar se marrëdhëniet ShBA - Kosovë aktualisht janë të tensionuara. Ai thotë se mungesa e leximit të realitetit do të jetë e kushtueshme për Kosovën, një kosto që do të ishte e padrejtë për popullin e Kosovës



OPINION

SITUATA PAT NË SHAHUN POLITIK F.6

Shkruan: Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



ARRESTIMI I VELIAJT, RAMA NGRE PIKËPYETJE NDAJ PROKURORISË SË POSAÇME F.2

TRUMPI VENDOS TARIFA PREJ 25 % NË TË GJITHA IMPORTET E ÇELIKUT DHE ALUMINIT F.2

KQZ-ja: 80 % E TË REGJISTRUARVE NË DIASPORË VOTUAN PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT F.3

EKONOMI



BERZH-I KA INVESTUAR 113 MILIONË EURO NË KOSOVË NË VITIN 2024 F.8

ODA EKONOMIKE AMERIKANE DHE ATK-JA DISKUTOJNË PËR PLANET DHE INICIATIVAT E ADMINISTRATËS TATIMORE F.8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi vendos tarifa prej 25 % në të gjitha importet e çelikut dhe aluminit

WASHINGTON, 11 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ka vendosur 25 për qind tarifa në të gjitha produktet e çelikut dhe aluminit që hyjnë në Shtetet e Bashkuara, duke kërcënuar me përshkallëzim të luftës tregtare, që ka tronditur tregjet në gjithë botën. Trumpi ka marrë vendim për rritje të tarifave amerikane ndaj aluminit në 25 për qind, për dallim nga tarifa e mëparshme prej 10-përqindësh, si dhe i ka anuluar marrëveshjet për kuota, apo përjashtime të tjera specifike për të dyja metalet. Shtëpia e Bardhë ka konfirmuar se masat do të hyjnë në fuqi prej 4 marsit. Tarifat do të zbatohen për miliona tonë të importeve të çelikut dhe aluminit nga Kanada, Brazili, Meksika dhe Koreja e Jugut, si dhe shtete të tjera, mallrat e të cilave kanë hyrë në ShBA pa ndonjë taksë shtesë. Trumpi u ka thënë gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë se ky vendim vetëm se do t'i thjeshtojë tarifat ndaj metaleve. “Është tarifë 25 për qind, pa asnjë përjashtim. Për të gjitha shtetet, pavarësisht ku janë”, ka thënë ai. Trumpi ka thënë më vonë se do ta marrë në konsideratë kërkesën e Australisë për

përjashtim prej tarifave në produktet e çelikut për shkak të deficitit tregtar me ShBA-në. Statistikat qeveritare dhe ato të industrive tregojnë se Kanada, Brazili, Meksika dhe Koreja e Jugut janë vendet prej të cilave importohet më së shumti çelik në ShBA. Kanada është mbrapa 80 për qind të importeve të aluminit në ShBA. Trumpi u ka thënë gazetarëve se më 11 apo 12 shkurt do t'i bëjë publike “tarifat reciproke” ndaj shteteve që veçse kanë vendosur tarifa në produktet amerikane. “Nëse ata kanë vendosur tarifa prej 130-përqindësh, e ne nuk u kemi vendosur asgjë, nuk do të jetë më ashtu”, ka thënë Trumpi. Këshilltari i Trumpit për tregti, Peter Navarro, ka thënë se masat e fundit do t'u ndihmojnë prodhuesve amerikanë të çelikut dhe aluminit, që ta rrisin tregtinë dhe sigurinë kombëtare të ShBA-së. “Kjo s'ka të bëjë vetëm me tregti. Ka të bëjë me të garantuarit që Amerika nuk do të varet asnjëherë nga shtetet e huaja për industrinë kritike sikurse çeliku dhe alumini”. Ekspertët kanë thënë se tarifat do ta prekin gjithë ekonominë e botës.



Më 3 shkurt Trumpi i ka paralajmëruar amerikanët se masat ekonomike mund t'i godasin ata, pasi ka marrë vendim për vendosje të tarifave tregtare ndaj Kanadasë, Meksikës dhe Kinës - tre partnerëve më të mëdhenj tregtarë të ShBA-së. Më vonë ai ka marrë vendim për t'i pezulluar për 30 ditë masat ndaj Kanadasë dhe Meksikës, dhe ka thënë se liderët e dy shteteve janë zotuar për masa më të fuqishme tregtare, me qëllim të ndaljes së migrimit të paligjshëm dhe

hyrjes së drogave të paligjshme në tokën amerikane. Presidenti amerikan ka kërcënuar edhe me vendosje të tarifave në mallrat e Bashkimit Evropian, duke thënë se diçka e tillë do të ndodhë shumë shpejt. Ai ka sugjeruar se edhe Britania e Madhe mund të jetë në shënjestër të tarifave. Trumpi është ankuar që një kohë për tarifën e BE-së, prej 10-përqindësh, në makinat amerikane, përderisa tarifa amerikane në makinat evropiane është 2.5 për qind, ndonëse tarifa varet edhe nga

lloji i makinës. Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë më 9 shkurt se tarifën amerikane ndaj Evropës do ta rrisnin inflacionin në ShBA, dhe ka thënë për rrjetin televiziv amerikan CNN se Trumpi nuk duhet të fokusohet në aleatët e Amerikës brenda BE-së. Tregjet e aksioneve janë çrregulluar pasi Trumpi pati vendosur tarifën fillestare kundër Kanadasë, Meksikës dhe Kinës, mirëpo më vonë janë qetësuar, pasi ai ka shprehur gatishmëri t'i negociojë masat.

Arrestimi i Veliajt, Rama ngre pikëpyetje ndaj Prokurorisë së Posaçme

TIRANË, 11 SHKURT - Në Shqipëri, kryeministri Edi Rama ka ngritur të martën pikëpyetje ndaj Prokurorisë së Posaçme pas arrestimit të dëshmitarit të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, dhe lënies në arrest shtëpie të bashkëshortes së tij Ajola Xoxa. Të dy dyshohen për korrupsion në 9 raste e pastrim parash, ndërsa Xoxa edhe për mosdeklarim të pasurisë. Rama foli për frikësim të dëshmitarëve nga ana e hetuesve, ndërsa e cilësoi të “çuditshëm” hetimin ndaj kryebashkiakut. Në bashkëbisedimin e tij me komentuesit në rrjetet sociale, Rama ka thënë se zgjedhja për të mos komentuar veprimet e institucioneve të drejtësisë nuk mund të vijoje më, tani që, sipas tij, pas 5 vitesh, këto institucione janë konsoliduar. “Asnjë pendesë, asnjë pendesë për heshtjen këto 5 vjet, por me shumë gjasë, besoj, në dritën e zhvillimit më të fundit, heshtja jonë është keqkuptuar edhe nga disa konsumatorë të reformës. Pra, këta konsumatorë duhet t'ua kursejnë shtetit dhe shoqërisë çorbën e derrit në



menynë e drejtësisë”, ka thënë Rama. Kryeministri u shpreh se “ndarja me komunitetin nga sistemi i drejtësisë dhe njëkohësisht me publikun hapur, në mënyrë transparente e opinionëve kritike është gjëja më e dobishme që tani mund të bëjmë ne në këtë fazë të re për të mos lejuar që në emër të qëllimit tonë madhor të

pavarësisë së drejtësisë nga pushteti politik, individë të caktuar t'i japin vetes të drejtën e shpërdorimit të detyrës së prokurorit apo të gjykatësit, duke shkelur kufijtë ndarës mes pushteteve kushtetuese”. Për rastin e Veliajt, kryeministri tha se ishte shqetësuar seriozisht nga “frikësimi i disa personave të marrë në pyetje. Njerëz të artit dhe të kulturës që


u gjenden krejt pafajësisht në situata të denja vetëm për letërsinë e Franc Kafkës”, deklaroi ai, duke shtuar se nuk donte të hynte më në detaje e të mos nxitohej. “Do të mundohemi të krijojmë një opinion të konsoliduar për aktakuzën për të cilën gjykatësi ka firmosur t'ia heqë kokën nga shpatullat bashkisë së Tiranës duke e lënë praktikisht pa

drejtim një kryeqytet me 1 001 punë në ditë, pa gjyq. Pa gjyq!”. Sipas tij, “prezumimi i pafajësisë nuk mund të jetë një rresht aty në fund ku, pasi e shqyen dikë dhe pasi e merr pa gjyq nga detyra dhe e çon e mbyll brenda dhe jo nga një detyrë dosido, por nga drejtimi i kryeqytetit, shkruan aty ‘Prezumohet i pafajshëm’”. Ashtu si dhe vetë Veliaj, kur pas daljes nga Prokuroria e Posaçme në fund të dhjetorit, i mëshoi faktit se ishte denoncuar nga një person anonim, edhe Rama foli për një proces hetimor të çuditshëm. “Për ta thënë minimalisht siç e shoh, shumë të çuditshëm. I nisur nga një novelë pafundësi fletësh. Novelë anonime dorëzuar në shkurtin e kaluar në SPAK që ka pjellë një roman 400 faqesh afërisht ku autorët e veshur me pushtetin e drejtësisë, prokurori dhe gjykatësi paraprak, bashkë kanë arritur në pikën që edhe nënën e një fëmije 6 vjeç ta dënojnë me arrest shtëpie pasi babanë e kanë çuar në paraburgim”, ka thënë Rama.

DUKE U BAZUAR NË VOTAT E RREGULLTA TË NUMËRUARA DERI NË MËNGJESIN E 11 SHKURTIT, KËSHITU PRITET TË SHPËRNDAHEN VENDET NË KUVENDIN E KOSOVËS

LV-ja 47 deputetë, PDK-ja 25, LDK-ja 20 dhe AAK-ja 8

Përfaqësuesi i koalicionit të organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim, Eugen Cakolli, ka thënë se tashmë që rezultatet e vendvotimeve të rregullta në Kosovë pothuajse janë përfundimtare, ndarja e mandateve në Kuvendin e Kosovës për partitë shqiptare është kjo: LV-ja 47 deputetë, PDK-ja 25 deputetë, LDK-ja 20 deputetë dhe AAK-ja 8 deputetë. Ai ka thënë se votat e partive që nuk e kalojnë pragun as nuk shpërndahen e as nuk i shtohen ndonjë partie tjetër

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 SHKURT - Eugen Cakolli, përfaqësues i koalicionit të organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim, ka thënë se tashmë që rezultatet e vendvotimeve të rregullta në Kosovë pothuajse janë përfundimtare, ndarja e mandateve në Kuvendin e Kosovës për partitë shqiptare është kjo: LV-ja 47 deputetë, PDK-ja 25 deputetë, LDK-ja 20 deputetë dhe AAK-ja 8 deputetë. “Edhe pse ende mbeten në kalkulum rreth 100-120 mijë vota, përfshirë ato jashtë vendit dhe votat me kusht, ndikimi i tyre në rezultatin përfundimtar do të jetë marginal. Derisa votat me kusht ndjekin të njëjtin trend si votat e rregullta, në votat jashtë vendit LV-ja tradicionalisht performon dukshëm më mirë (bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të kaluara). Specifikisht: Nëse LV-ja fiton rreth 60 % të votave jashtë vendit, mund të marrë dy mandate shtesë, duke arritur në gjithsej 49 deputetë. Në variantin më pozitiv për LV-në,

kur fiton mbi 75 % të votave jashtë vendit, mund të arrijë deri në 51 deputetë. Ndërsa në variantin negativ për LV-në, kur merr më pak se 50 % të votave jashtë vendit, mund të bjerë në 46 mandate”, ka thënë Cakolli. Ai ka thënë se votat/përqindja e partive që nuk e kalojnë pragun, as nuk shpërndahen e as nuk i shtohen ndonjë partie tjetër. “Ato thjesht nuk llogariten gjatë ndarjes së mandateve”, ka thënë ai. Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim, vlerëson se zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit u zhvilluan në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të drejta. Administrimi i operacioneve zgjedhore ishte përgjithësisht i rregullt, përjashtuar procesin e publikimit të rezultateve dhe numërimit të votave për kandidatët. Sipas këtij koalicioni, procesi i votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve është zhvilluar përgjithësisht në një atmosferë të qetë dhe demokratike, i karakterizuar nga një interesim relativisht i

lartë i votuesve për të marrë pjesë në zgjedhje. Megjithatë, procesi i votimit është shoqëruar me disa parregullsi dhe shkelje, kryesisht të natyrës procedurale. Nuk është raportuar për incidente serioze gjatë votimit që do të mund ta cenonin integritetin e zgjedhjeve. “Problemet teknike me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve të KQZ-së, të shfaqura vetëm disa orë pas përfundimit të votimit, krijuan konfuzion dhe ulën besimin e publikut në transparencën e procesit. Kjo situatë la një impakt negativ në perceptimin për organizimin zgjedhor. Është për t'u përhëndetur qasja vetëpërmbytëse e subjekteve politike kryesore, që pas përfundimit të votimit, përkundër problemeve me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve, i

kanë njohur dhe pranuar në mënyrë të qetë rezultatet preliminare të zgjedhjeve për subjektet politike”, është thënë në komunikatën e Demokracia në Veprim. Më tej thuhet se fushata zgjedhore ishte dinamike, atraktive dhe programore, ndërsa diskursi politik gjatë fushatës ishte i ashpër, veçanërisht nga partia në pushtet, që rezultoi në një numër rekord të gjobave të shqiptuara nga PZAP-ja, me një vlerë të përgjithshme mbi 600 mijë euro. “Në këto zgjedhje aplikuan për certifikim 28 subjekte politike me gjithsej 1 280 kandidatë. Në përgjithësi, KQZ miratoi aplikacionet e të gjitha subjekteve, me përjashtim të Listës Serbe, vendimi për të cilën shkaktoi debat të gjerë dhe ngriti shqetësime mbi qasjen e barabartë në garën zgjedhore. Në këtë rast,

kundërligjshëm refuzoi certifikimin e saj, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike. Më vonë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme vendosën për certifikimin e këtij subjekti, duke e korrigjuar vendimin fillestar të KQZ-së, duke shfaqur dominimin e konsideratave politike mbi parimet ligjore në disa aspekte të administrimit të zgjedhjeve. Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u monitoruan nga një numër i konsiderueshëm vëzhguesish, duke përfshirë përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile, misioneve ndërkombëtare dhe medieve. Në total, mbi 20 000 vëzhgues u akredituan për ta mbikëqyrur mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në të gjitha nivelet”, ka theksuar në këtë komunikatë DnV-ja.

KQZ-ja: 80 % e të regjistruarve në diasporë votuan për zgjedhjet e 9 shkurtit

PRISHTINË, 11 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se 80.1 për qind e pjesëtarëve të diasporës kanë votuar për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë të martën se në përfaqësitë diplomatike kanë votuar 15 352 qytetarë, ndërsa me postë 68 712. Megjithatë, ai ka tërhequr vërejtjen që kjo përqindje mund të ndryshojë, pas procesit të vlerësimit të votave që janë pranuar me postë. Mbi 2 milionë shtetas të

Kosovës kanë pasur të drejtë të votojnë në zgjedhjet parlamentare të këtij viti. Në mesin e tyre kanë qenë edhe 104 924 votues nga diaspora. Ky ka qenë procesi i parë zgjedhor kur pjesëtarëve të diasporës u është mundësuar votimi në 19 përfaqësi diplomatike në gjithë botën. Elezi ka thënë se numërimi i votave nga diaspora do të nisë të bëhet pas disa ditësh në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve. Sipas rezultateve preliminare, pas numërimit të mbi 90 për qind të votave,



partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ka fituar mbi 40 për të votave, e përcjellë nga Partia Demokratike e

Kosovës me rreth 22 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës me rreth 17 për qind të votave,

dhe koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate, rreth 7 për qind të votave.

Një partie i duhen 61 vota të deputetëve në Kuvend për ta formuar qeverinë e re. Aktualisht asnjëra parti nuk i ka ato. Partitë që aktualisht janë në opozitë kanë përjashtuar mundësinë e ndonjë koalicioni me Lëvizjen Vetëvendosje për ta formuar qeverinë.

Analistët vlerësojnë se në ditët, javët ose edhe muajt në vijim, Kosovën e presin turbulenca politike.



Shtuni: Jemi në një fazë problematike të marrëdhënieve Kosovë - ShBA

Adrian Shtuni, ekspert për politikë të jashtme dhe siguri që vepron në Uashington, ka theksuar se marrëdhëniet ShBA - Kosovë aktualisht janë të tensionuara. Ai thotë se mungesa e leximit të realitetit do të jetë e kushtueshme për Kosovën, një kosto që do të ishte e padrejtë për popullin e Kosovës. I pyetur nëse ShBA-ja do të ketë angazhim më të madh në dialogun Kosovë - Serbi, sapo Kosova të formojë një qeveri të re, Shtuni tha se kjo varet edhe nga formati i bisedimeve, por edhe nga koha që do t'ia marrin administratës Trump problemet e tjera gjeopolitike në botë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Adrian Shtuni, ekspert për politikë të jashtme dhe siguri që vepron në Uashington, tha për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria e re e Kosovës nga cilado forcë politike që formohet, duhet ta ketë të qartë realitetin mbi marrëdhëniet aktuale të Kosovës me aleatët dhe të krijojë një strategji për politikën e jashtme. Në intervistën për "REL"-in, Shtuni shtoi se raportet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të trajtohen me seriozitet, sidomos tash kur në ShBA është president Donald Trump. "Në qoftë se e kuptojmë se çfarë prioriteti ka presidenti Trump, në qoftë se vazhdohet me dredhi, me gjysmë të

vërteta dhe premtime të pambajtura, kam përshtypjen se ka për të pasur probleme në marrëdhënie", theksoi ai. I pyetur nëse ShBA-ja do të ketë angazhim më të madh në dialogun Kosovë - Serbi, sapo Kosova të formojë një qeveri të re, Shtuni tha se kjo varet edhe nga formati i bisedimeve, por edhe nga koha që do t'ia marrin administratës Trump problemet e tjera gjeopolitike në botë.

Cilat janë detyrat që e presin qeverinë e re të vendit, pavarësisht nga kush formohet, sa iu përket raporteve me aleatët?

Adrian Shtuni: Janë dy-tri pika, detyra kryesore është riparimi i marrëdhënieve me aleatët dhe

mirëmbajtja e tyre, do të thotë po flas për partnerët strategjikë, sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky partneritet duhet të trajtohet me seriozitet, me maturi dhe, mbi të gjitha, me ndershmëri, sepse më duket sikur edhe nga retorika ka munguar ndershmëria ose sinjeriteti, sidomos jo vetëm në komunikimin me partnerët, por edhe me publikun, ku në njëfarë mënyre është shitur sapuni për djathë.

Do të thotë, marrëdhëniet me aleatët, me partnerët strategjikë nuk janë në një pikë të mirë, kjo nuk është në favor të Kosovës. Prandaj, ata që e kanë sjellë në këtë pikë duhet të jenë të sinqertë në komunikimin me publikun dhe

ta pranojnë këtë gjë dhe të japin llogari pse është në këtë pikë marrëdhënia me partnerët strategjikë. Po të shikojmë pikën e dytë në plan më të gjerë, politika në Kosovë duhet të lexojë qartë dhe pa asnjë vonesë lëvizjen tektonike në skenën politike, si në aspektin gjeopolitik dhe në politikën e brendshme të ShBA-së. Prandaj, duhet një rikalibrim i menjëhershëm i politikës në Kosovë - pavarësisht se kush e formon Qeverinë - ndaj qasjes me Shtetet e Bashkuara, me Bashkimin Evropian, me NATO-n dhe duhet të ketë një prezencë të shtuar në tavolinat si bilaterale ashtu edhe multilaterale, pra si i drejtpërdrejtë komunikimi me SHBA-në këtu në Uashington ashtu edhe në forumet ndërkombëtare ku komunikohet qartë me partnerët strategjikë. Duhet të jemi të qartë për një gjë, është koha që të heqim dorë nga nacionalizmi romantik, folkloristik dhe për ta zëvendësuar atë me patriotizëm pragmatik dhe strategjik. Kosova do të përballlet me sfida shumë shpejt, edhe për arsye të

ndryshimeve politike në ShBA, edhe për shkak të ndryshimeve gjeopolitike, prandaj duhet që kushdo që të jetë në qeveri, të ketë një qasje strategjike dhe të krijojë një forum këshillimi strategjik për politikën e jashtme dhe për menaxhimin e dialogut me Serbinë.

Kur flasim për raportet e Kosovës me ShBA-në, z. Shtuni, si i komentoni deklaratat e fundit nga Richard Grenell, i dërguar i ShBA-së për misionet të veçanta në lidhje me kryeministrin Kurti dhe qeverinë e tij, duke e cilësuar atë si partner jo të besueshme?

Adrian Shtuni: Kjo lloj deklarate është mjaft brengosëse, por nuk është befasuese. Në çdo marrëdhënie, qoftë familjare, shoqërore a politike, besueshmëria cenohet kur ti thua një gjë dhe bën një gjë tjetër dhe nuk i përmbahesh fjalës që ke dhënë, nuk u përmbahesh obligimeve që ke marrë para partnerëve. Pra, besueshmëria padyshim është cenuar, besueshmëria e Qeverisë së Kosovës si interlekutor, dikush e thotë me fjalë, dikush e thotë me vepra.

Janë pikërisht sjelljet sfiduese jobashkëpunuese që e kanë sjell Kosovën në këtë gjendje ku është nën masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian.

Edhe masat të njëjtën gjë komunikojnë, sepse nuk ka arsye të marrësh masa nëse je bashkëpunues. Pra, duhet të lexohet qartë realiteti dhe komunikimi me popullin duhet të jetë më i sqartë dhe më pak përralla me babadimrin. Ata që nuk e kuptojnë se marrëdhëniet ShBA-Kosovë apo BE-Kosovë aktualisht janë të tensionuara, jetojnë në një realitet paralel dhe mungesa e leximit të realitetit do të jetë e kushtueshme për Kosovën, një kosto që do të ishte e padrejtë për popullin e Kosovës.

Gjatë fushatës Kurti thoshte se opozita po përpiqet të gjejë dikë në Uashington që ta sulmojë qeverinë e tij. A mund të jetë nxitur nga opozita në Kosovë deklarimi i fundit i Grenellit?

Adrian Shtuni: Z. Grenell nuk është mashë, nuk është instrument i politikës së Kosovës dhe kushdo që e thotë këtë, është naiv dhe nuk e kupton si është politika dhe për këtë është duke folur, kur flasim për politikën në ShBA jo në Ballkan. Z. Grenell gëzon besueshmëri të plotë te presidenti Trump, ka qasje të drejtpërdrejtë, e ka veshin e tij, presidenti Trump e dëgjon atë dhe Grenell ka ndikim të madh në këtë administratë. Për këtë

arsye deklaratat e tij duhet të merren seriozisht dhe çdo përgjigje ndaj tyre duhet të peshohet me kujdes dhe jo të krijohen lojëra dhe narrativë të pabesueshëm se z. Grenell qenka instrumentalizuar nga opozita, gjë e cila për mua është aspak e besueshme.

Sipas Kurtit, partneriteti i Kosovës me ShBA-në në të kaluarën ka qenë ose me agresivitet ose me servilitet, kurse ai thotë se partneritetin me ShBA-në e sheh me normalitet. Si ju duket ky përkufizim i marrëdhënieve?

Adrian Shtuni: Prapë po them duket se ka një shkëputje nga realiteti që e njohim të gjithë, sepse ne në të njëjtin realitet jetojmë dhe dëgjojmë të njëjtat komente nga të gjithë liderët, ambasadorët e përfaqësuesit shtetërorë, unë nuk e ndaj të njëjtin mendim me z. Kurti. Përkundrazi, nëse e shohim nga pikëvështrimi amerikan dhe i Bashkimit Evropian po flas nga deklaratat që kanë bërë zyrtarët e ShBA-së dhe Bashkimit Evropian dhe jo nga një person, po flasim për qasje të ShBA-së, BE-së e NATO-s më rezulton që ka një problem në mënyrën e komunikimit dhe të veprimit nga ana e Qeverisë aktuale të Kosovës me partnerët.

Nuk më duket se janë ankuar për bashkëpunimin me qeveritë e kaluara të Kosovës,

përkundrazi nëse e mbajmë mend deklaratën e ish-ambasadorit Hovenier që tha “po përballemi me sfida të ndryshme nga Qeveria aktuale dhe ky është ndryshimi nga marrëdhëniet që kemi pasur më parë me qeveritë e kaluara”. Dhe, nëse ka një dëmtim të nivelit të partneritetit midis Kosovës dhe ShBA-së, pra rënie të cilësisë së partneritetit, atëherë kemi rënie në krahasim të asaj që ka qenë më përpara, që do të thotë se më përpara partneriteti ka qenë më i besueshëm dhe ka qenë në vendin ku duhet të ishte, për të arritur synime që janë arritur gradualisht, me njohjen e shtetësisë së Kosovës, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare etj.

Unë nuk po them që marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka qenë perfekte ose që s’ka pasur probleme, por krahasimisht siç është tani me më përpara, mund të themi se tani jemi në një fazë problematike të marrëdhënieve Kosovë-ShBA, po flas për marrëdhënie shtetërore.

Nëse nga këto zgjedhje del një qeveri me Vetëvendosjen në udhëheqje, si pritet të jenë marrëdhëniet me ShBA-në që tash ka president Donald Trumpin?

Adrian Shtuni: Unë sugjeroj që marrëdhënia e Kosovës me ShBA-në është jetike, është

marrëdhënie që duhet prioritetizuar, që duhet të shikohet me seriozitet të jashtëzakonshëm, sidomos duke pasur parasysh mënyrën se si presidenti Trump parapëlqen të komunikojë, është shumë i drejtpërdrejtë dhe e vlerëson shumë besnikërinë. Në qoftë se e kuptojmë se çfarë prioriteti ka presidenti Trump, në qoftë se vazhdohet me dredhi, me gjysmë të vërteta dhe premtime të pambajtura, kam përshtypjen se ka për të pasur probleme në marrëdhënie dhe kjo nuk imitohet te një qeveri apo te një tjetër, kushdo që e bën Qeverinë në Kosovë, duhet të jetë i qartë për realitetin në të cilin jemi aktualisht.

A ka rrezik që këto marrëdhënie shtetërore Kosovë - ShBA të ndikojnë edhe në marrëdhëniet e ShBA-së me popullin e Kosovës?

Adrian Shtuni: Fatkeqësisht, për shkak të momentit ku jemi dhe paparashikueshmërisë së rrjedhës së gjërave, ekziston mundësia që edhe populli të ketë pasoja, jo vetëm në aspektin e asaj që nuk dihet, por edhe të asaj që dihet. Po të shohim janë bllokuar fondet zhvillimore të Bashkimit Evropian, ajo është në një mënyrë të drejtpërdrejtë ndikuese në mirëqenien e popullit të Kosovës, për të mos u futur në aspektet e sigurisë se çfarë do të ndodhte nëse do të kishte një lodhje tek aleatët me

qasjen jobashkëpunuese dhe pastaj do të rishikonin qasjen e tyre ndaj Kosovës. Kushdo që e formon Qeverinë, duhet të zgjohet dhe të kuptojë se jemi para një momenti vendimtar për të ardhmen e Kosovës.

A pritet angazhim më i madh i administratës Trump në procesin e dialogut Kosovë - Serbi pasi Qeveria e re ta marrë detyrën?

Adrian Shtuni: Angazhimi i ShBA-së me Kosovën nuk është unilateral, por varet edhe me mënyrën se si sillet Kosova. Unë shpresoj se do të ketë një angazhim më të madh të ShBA-së për të gjetur një formulë që të arrihet normalizimi në terren i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Por, nuk varet vetëm nga Shtetet e Bashkuara, varet edhe nga formati i paraparë, i zbatuar tash e një dekadë ku është Bashkimi Evropian ai që ndërmjetëson bisedimet.

Duhet pasur parasysh që në planin gjeopolitik jemi duke përjetuar shumë sfida, të cilat janë goxha më të mëdha në planin global. Po flas, ka një luftë në Ukrainë, probleme të tjera në Gaza, në Lindjen e Mesme, në Siri, ka probleme madhore për mënyrën se si po sillet Kina ndaj Tajvanit dhe fqinjëve të tjerë, dhe kështu ka shumë probleme më të mëdha që do të tërheqin vëmendjen dhe do të marrin kohën e administratës Trump para procesit të dialogut Kosovë - Serbi.

Oda Ekonomike Amerikane dhe ATK-ja diskutojnë për planet dhe iniciativat e administratës tatimore

PRISHTINË, 11 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka zhvilluar një diskutim të rëndësishëm me ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Ilir Murtezaj, për planet dhe iniciativat e administratës tatimore. Diskutimi përfshiu ndryshimet ligjore që ndikojnë në procedurat tatimore, sfidat e rimbursimeve tatimore dhe vonesat që lidhen me interpretimin e ligjit. Murtezaj ka theksuar rëndësinë e dallimit midis tatimpaguesve që nuk respektojnë ligjin dhe atyre që kanë vështirësi në interpretimin e tij. Ai, gjithashtu, ka theksuar suksesin e ATK-së për arritjen e një shkalle të lartë të përmbushjes tatimore dhe angazhimit të administratës për ta përmirësuar sistemin tatimor, rritur transparencën dhe besueshmërinë. Temat e tjera të diskutimit përfshijnë nevojën për seminare dhe trajnime për bizneset mbi procedurat e ankesave dhe



rishikimin e inspektimeve tatimore për një qasje më të drejtë dhe transparente. Rëndësi iu dha edhe shqyrtimit të ankesave nga Bordi për Ankesa pranë Ministrisë së Financave, ku u udhëzuan bizneset që, duke marrë parasysh mungesën e

kapacitetit të punës, e cila pamundëson zgjidhjen e të gjitha ankesave brenda afatit kohor, për të njëjtat çështje të iniciohet padia në gjykatë. Digjitalizimi i shërbimeve tatimore ishte, gjithashtu, një çështje kyçe në përpjekjet për ta

rritur efikasitetin dhe ulur keqinterpretimet. “Si AmCham, ne mbetemi të angazhuar për të kontribuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset në Kosovë. Puna jonë vazhdon të fokusohet në rritjen e bashkëpunimit mes

institucioneve shtetërore dhe sektorit privat, duke përmirësuar procedurat dhe duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë në administratën tatimore”, ka njoftuar Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Deklarata e Bedri Hamzës dhe impakti politik në Kosovë



Shkruan: Prof.
Dr. Fejzulla BERISHA

Deklarata e Bedri Hamzës: Përcaktim politik me pjekuri politike dhe shtetërore për Republikën e Kosovës

Deklarata e Bedri Hamzës, e cila përjashton çdo mundësi të një koalicioni midis Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), nuk është thjesht një qëndrim momental politik. Ajo reflekton një ndryshim të thellë në ekuilibrat politikë dhe një përgjigje ndaj asaj që ai e quan “eksperimentim politik të Kosovës me aleatët perëndimorë - ShBA dhe BE”. Ky qëndrim sinjalizon një rreshtim të ri në skenën politike të Kosovës, ku marrëdhëniet me Perëndimin po kthehen në faktor kyç për përcaktimin e qeverisjes së ardhshme.

1. Refuzimi i PDK-së për një koalicion me LVV: Rastet konkrete dhe implikimet

Ky refuzim nuk është thjesht një qëndrim elektoral, por një lëvizje strategjike që reflekton hendekun e madh mes PDK-së dhe LVV-së, veçanërisht në raport me politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me ShBA-në dhe BE-në.

1.1 Raportet e Qeverisë Kurti me ShBA-në dhe BE-në

Ish-qeveria e Albin Kurtit ka pasur përplasje të ashpra me aleatët perëndimorë, të cilat kanë rezultuar në izolim diplomatik dhe masa ndëshkuese ndaj Kosovës: Sanksionet e ShBA-së (2023): Pas tensioneve në veri të Kosovës, ShBA vendosi sanksione ndaj qeverisë së Kurtit, duke përjashtuar Kosovën nga Defender Europe 2023, një stërvitje e rëndësishme e NATO-s. Ky ishte një sinjal i qartë se ShBA-ja nuk ishte e kënaqur me qasjen e Kurtit ndaj menaxhimit të situatës në veri. Masat e BE-së: BE pezulloi një pjesë të fondeve për Kosovën dhe refuzoi të vazhdonte me procesin e liberalizimit të vizave pa përmbushjen e disa kushteve të vendosura, duke reflektuar shqetësimet mbi qëndrimin e Kurtit ndaj dialogut me Serbinë.

1.2 Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe: Pika kyçe e përplasjes

Një nga pikat më të mëdha të tensionit midis qeverisë Kurti dhe Perëndimit ka qenë refuzimi i Kurtit për të implementuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe: Presioni i ShBA-së dhe BE-së: Të dyja palët kanë kërkuar zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, duke argumentuar se Kosova është e detyruar ta respektojë atë si një marrëveshje ndërkombëtare. Qëndrimi i Kurtit: Ai e ka quajtur Asociacionin një “Republika Srpska” të dytë, duke e krahasuar atë me strukturën paralizuese të entitetit serb në Bosnjë.

Reagimi i ShBA-së: Pas këtij refuzimi, ShBA uli nivelin e takimeve diplomatike me Kosovën dhe kërcënoi me ndalimin e ndihmës financiare dhe ushtarake. Në këtë kontekst, PDK përpiqet të paraqitet si një forcë politike që do të rivendosë marrëdhëniet e Kosovës me Perëndimin, duke u diferencuar nga LVV.

2. “Eksperimentimi politik” me ShBA dhe BE: Rastet konkrete dhe pasojat

Përdorimi i termit “eksperimentim politik” është një kritikë e drejtpërdrejtë ndaj politikave të qeverisë Kurti, të cilat kanë sjellë përplasje me aleatët tradicionalë të Kosovës.

2.1 Përplasja me QUINT-in mbi veriu në Kosovës

Një nga momentet më kritike ka qenë menaxhimi i krizës në komunat veriore me shumicë serbe: Ndërhyrja e Policisë së Kosovës (2023): Kurti dërgoi forca të Policisë së Kosovës për të vendosur kryetarët shqiptarë të komunave, pas një procesi zgjedhor të bojkotuar nga serbët. Reagimi i QUINT-it: ShBA dhe

BE kërkuar të mos përshkallëzohej situata dhe të organizoheshin zgjedhje të reja, por Kurti refuzoi. Sanksionet e ShBA-së: Për pasojë, ShBA vendosi sanksione diplomatike, duke ngrirë marrëveshjet e bashkëpunimit në mbrojtje dhe duke ndaluar ndihmat financiare të planifikuara për Kosovën. Ky rast u pa si një shembull konkret i “eksperimentimit politik”, ku qasja konfrontuese e qeverisë Kurti solli pasojë të prekshme për Kosovën.

3. Pozicionimi i PDK-së si alternativë pro-perëndimore: Strategjia dhe implikimet

PDK, me këtë deklaratë të Bedri Hamzës, synon të vendoset si një forcë politike që mbron partneritetin e Kosovës me ShBA-në dhe BE-në, duke kontrastuar qeverisjen e Kurtit.

3.1 Qasja e PDK-së ndaj ShBA-së dhe BE-së në të kaluarën

PDK ka një histori të gjatë të bashkëpunimit të ngushtë me aleatët perëndimorë: Qeverisja e Hashim Thaçit dhe

Kadri Veselit: Formimi i Ushtrisë së Kosovës: Me mbështetjen e ShBA-së, u miratua transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në: Një hap i rëndësishëm drejt integritetit evropian të Kosovës. Mbështetja për NATO-n: PDK ka qenë gjithmonë pro zgjerimit të rolit të NATO-s në Kosovë dhe ka lobuar për anëtarësimin e Kosovës në këtë aleancë. Me këtë histori si bazë, PDK synon të shfrytëzojë pakënaqësitë me qeverinë Kurti për të rritur ndikimin e saj politik.

4. Implikimet për politikën kosovare

Deklarata e Bedri Hamzës nuk është thjesht një refuzim i një koalicioni të mundshëm, por një tregues i një ristrukturimi të madh politik në Kosovë: PDK po pozicionohet si partia që do të riparojë marrëdhëniet me ShBA-në dhe BE-në. LVV po izolohet gjithnjë e më shumë, duke vështirësuar ndërtimin e aleancave të ardhshme. Presioni mbi Kurtin do të rritet nga brenda dhe jashtë vendit, duke e detyruar ose të ndryshojë kursin politik ose të përballet me një izolim më të madh. Në këtë kontekst, raportet me Perëndimin po bëhen përcaktuese për të ardhmen e çdo partie politike në Kosovë. PDK, përmes kësaj deklarate, është përpjekur dhe po përpiqet të kapitalizojë mbi këtë moment politik për të rikthyer veten në qendër të skenës politike për të ardhmen politike bashkëpunuese dhe integrimin e Kosovës në organizmat më të fuqishëm ndërkombëtar, si në OKB, BE dhe në Paktin Veriatlantik (NATO).

QKUK: Mbi 4 500 pacientë operuan sytë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Mbi 4 500 pacientë janë operuar në Klinikën e Syve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë vitit 2024. Në njoftimin e QKUK-së thuhet se ky numër është rritur për 500 krahasuar me vitin paraprak. “Rritja e numrit të operacioneve dhe performancës është bërë falë investimeve që janë bërë nga Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK, qoftë në investimet në infrastrukturë, po ashtu edhe në resurse humane dhe

pajisje mjekësore”, thuhet në njoftim. Ndër të tjera, theksohet se në këtë klinikë janë kryer edhe mbi 45 mijë vizita ambulatorie specialistike dhe sub-specialistike në profile të ndryshme oftalmologjike. “Duhet theksuar se në këtë klinikë është rritur edhe gama dhe llojet e operacioneve, përfshirë edhe ato më të komplikuar, që ka mundur që referimet për trajtim jashtë vendit të ulen dukshëm”, ka njoftuar QKUK-ja.



Osmani takon nënpresidentin Vance, shpreh mirënjohje për aleancën me ShBA-në

PARIS, 11 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar në Paris me nënpresidentin e Shteteve të Bashkuara, J. D. Vance, në kuadër të një vizite që është duke zhvilluar në kryeqytetin e Francës, me ftesë të homologut të saj, Emmanuel Macron, për pjesëmarrje në një samit botëror për inteligjencë artificiale. Përmes një komunikate për medie, Presidenca ka thënë se Osmani ka shprehur mirënjohjen e thellë për aleancën e Kosovës me ShBA-në, “duke konfirmuar përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit në fusha të interesit të përbashkët”. Më herët gjatë këtij muaji, Osmani ka zhvilluar një mori takimesh me zyrtarë amerikanë dhe kongresistë në Uashington. Ajo ka thënë se me administratën e re amerikane të presidentit Donald Trump, Kosova synon ta thellojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes e të investimeve strategjike. “Mbështetja amerikane ka qenë dhe mbetet jetike për shtetin tonë”, pati thënë

Osmani pas një takimi me Brian Mast, kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve. Deklaratat e saj janë bërë në kohën kur Qeveria aktuale e Kosovës - në krye me Lëvizjen Vetëvendosje - është përballur me kritika nga zyrtarë të administratës amerikane. Më 3 shkurt, i dërguari amerikan për misionet të veçanta, Richard Grenell, ka thënë se ShBA-së i duhen partnerë të besueshëm në Ballkan, ndërsa qeveria e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, sipas tij, nuk është e tillë. Kabineti i Kurtit nuk i është përgjigjur kërkesës së Radios Evropa e Lirë, në lidhje me këto komente, por duke folur për një medium në Kosovë, “Istogu Channel”, ai ka përsëritur se marrëdhëniet me ShBA-në janë në nivelin më të mirë - në çka ka reaguar sërish Grenell, duke thënë se ato nuk kanë qenë kurrë në pikën më të ulët. Kurti ishte përballur me kritika edhe nga administrata paraprake amerikane e udhëhequr nga Joe Biden për



shkak të disa veprimeve të ndërmarra në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, të cilat lidheshin me zëvendësimin e targave serbe

me ato të Kosovës, heqjen e dinarit serb nga përdorimi apo mbylljen e institucioneve serbe. Kurti i ka justifikuar ato


veprime si hapa drejt shtrirjes së sundimit të ligjit në veri dhe ka thënë se ato janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Kosova me 44 pikë në Indeksin e Korrupsionit, KDI-ja: Luftimi i korrupsionit të bëhet prioritet për institucionet e reja të dala nga zgjedhjet

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 SHKURT - Transparency International ka publikuar Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) për vitin 2024. Ky indeks, që përfshin rezultatet për 180 shtete të botës, shpërfaq nivelet e perceptimit të korrupsionit në sektorin publik duke bazuar në raporte kredibile të organizatave globale si Banka Botërore, Freedom House, World Justice Project, Bertelsmann Foundation Transformation Index, Varieties of Democracy, Global Insights Country Risk - shumica e të cilave janë publikuar në vitin 2023.



CPI këtë vit tregon se mbi gjysma e vendeve të botës qëndrojnë nën mesataren globale që është 43 pikë dhe shumica e tyre nuk kanë bërë përpunim në luftimin e korrupsionit në sektorin publik. Regjioni i Evropës Juglindore

dhe Azisë Qendrore ku bën pjesë edhe Kosova, është regjioni me mesataren gati më të ulët në botë, kryesisht për shkak të problemeve të theksuara me sundimin e ligjit, autokracinë në rritje, cenimin e medieve të lira dhe

institucionet e dobëta demokratike. Kosova për vitin 2024 ka shënuar 44 pikë dhe është renditur e 73-a në ranglistën botërore. Në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, ajo është renditur pas Malit të Zi dhe ka lënë pas Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Që nga viti 2012, kur Kosova është bërë pjesë e vlerësimeve të CPI, progresi i saj ka qenë i vazhdueshëm, por i ngadaltë, me gjithsej 10 pikë në 12 vitet e fundit. Mali i Zi 46 pikë - vendi 65; Kosova 44 pikë - vendi 73; Shqipëria 42 pikë - vendi 80; Maqedonia e Veriut 40 pikë - vendi 88; Serbia 35 pikë - vendi

105; Bosnjë e Hercegovina 33 pikë - vendi 114. Pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe krijimit të institucioneve të reja qeverisëse, KDI degë e Transparency International në Kosovë kërkon që lufta kundër korrupsionit të vendoset si prioritet dhe të udhëhiqet nga një strategji kombëtare efektive e përcjell me resurse të nevojshme financiare. KDI kërkon nga institucionet e reja që llogaridhënia dhe transparenca në sektorin publik të përbrendësohen si standarde bazike të qeverisjes së mirë në mënyrë që të parandalohet shpërdorimi i resurseve publike, nepotizmi dhe disbalansi midis pushteteve.

Haradinaj takon ambasadorin e Francës, temë diskutimi mbarëvajtja e zgjedhjeve të 9 shkurtit

Prishtinë, 11 shkurt - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka takuar të martën ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me të cilin ka diskutuar për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 9 shkurtit, thellimin e marrëdhënieve mes dy vendeve tona mike dhe

perspektivën euroatlantike të Kosovës, me theks të veçantë për anëtarësimin në NATO. “Në këtë rrugëtim Franca mbetet partnere e rëndësishme strategjik. Vlerësova lart angazhimin e Francës për stabilitetin rajonal dhe mbështetjen e

vazhdueshme për shtetin tonë. Bashkëpunimi bilateral në shumë fusha ofron mundësi të reja për avancimin e interesave të përbashkëta dhe forcimin e miqësisë së kahershme mes dy popujve”, ka thënë Haradinaj pas takimit.



Bojkotimi i marketeve në Kosovë vazhdon edhe në fundjavë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Të hënën edhe në Kosovë ka filluar fushata për bojkotimin e marketeve të mëdha për shkak të çmimeve të larta, bojkot ky i cili do të vazhdojë edhe në fundjavë më 15-16 shkurt. Sipas organizatorit, Xhevat Kastrati ky bojkot vjen si pasojë e rritjes së çmimeve. “Rritja enorme e çmimeve vitet e fundit, mashtrimet me çmime të ndryshme për produkte të caktuara si dhe iniciativat e tjera të rajonit”, tha Kastrati. Sipas Kastratit, gjatë 10 shkurtit në Kosovë rreth 10 mijë qytetarë i janë bashkuar kësaj fushate. Me këtë fushatë kërkohet që të ulen çmimet e ushqimeve bazë e disa kërkesa të tjera. “Ne kërkojmë: Ulje afatgjatë të çmimeve nga marketet, investigim nga mediet dhe organet kompetente për mashtrimet me çmime,

rregullim ligjor për çmime përmes aplikimit të ligjit për çmimet tavan, transparencë më të lartë për qytetarët në lidhje me lëvizjen e çmimeve”, tha ai. Mbështetje për këtë fushatë ka dhënë edhe Selatin Kaçaniku, drejtor i Shogatës “Konsumatori”. “Është iniciativë e duhur, e qëlluar, e provokuar me çmime spekulative për 25 vjet me radhë”, tha Kaçaniku për rtv21. Sipas Kaçanikut, ky bojkot mund të sjellë rezultat. “Ligjet, standardet... edhe dinjiteti i qytetarit konsumator taksapagues - edhe pa parti e institucione, pa Qeveri, pa Kuvend, pa ministri e institucione, agjenci, mekanizma... po vjen në shprehje. Po e jep rezultatin e parë: Populli, sovrani, publiku, qytetari konsumator taksapagues... jep detyra,



ndërsa Kuvendi, qeveria... të gjithë të tjerët duhet të jenë në shërbim të tyre e jo në shërbim

të vetvetes dhe të interesave të ngushta”, tha ai. Në ndërkohë, sipas Agjencisë

së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni mesatar për vitin 2024 ka qenë 1.6 %, në vitin 2023 ka qenë 4.9 %, ndërsa në vitin 2022 ishte 11.6 %. Paga mesatare në Kosovë për vitin 2023, sipas ASK-së, ka qenë 506 euro neto. Në sektorin publik paga mesatare është 630 euro neto, ndërsa në sektorin privat 459 euro. Të dhëna për vitin 2024 nuk ka ende. Qeveria në tetor të vitit 2022 kishte miratuar Ligjin për Çmimet Tavan në Produktet Bazë, por opozita e kishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Kjo gjykatë në nëntor të vitit 2023 e kishte shpallur të pavlefshëm. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deficitit tregtar në dhjetor të vitit 2024 ka qenë 17.5 %. Sipas ASK-së, eksporti në dhjetor ka qenë 69 milionë euro, ndërsa importi 631.1 milionë euro.

Kosova dhe Gjermania nënshkruajnë marrëveshje për rregullimin reciprok të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave



PRISHTINË, 11 SHKURT - Ministri i Infrastruktūrës, Liburn Aliu, bashkë me Hartmut Hoppner, sekretarin e Shtetit në Ministrinë për Digjitalizim dhe Transport të Gjermanisë, dhe Michael Reiffenstuel, drejtor për Evropën Juglindore, Turqinë, OSBE-në dhe Këshillin e Evropës në Ministrinë e Jashtme Gjermane, nënshkruan marrëveshjen bilaterale për rregullimin reciprok të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet vendit tonë dhe Gjermanisë. Në këtë ngjarje ishte i pranishëm edhe ambasadori i Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti. “Përmes

kësaj marrëveshjeje do të rregullohet transporti ndërkombëtar i udhëtarëve, duke përcaktuar kushtet themelore për themelimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të transportit të udhëtarëve, si në linjat e rregullta ashtu edhe në transportin e grupeve të organizuara turistike. Pa dyshim, kjo marrëveshje është me rëndësi të veçantë, pasi kontribuon në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të vendit tonë në sektorin e transportit. Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës nuk është anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare në këtë sektor, marrëveshja do t’u

mundësojë operatorëve tanë qasje më të lehtë në tregun evropian, duke krijuar një korridor rrugor për ta lehtësuar lëvizjen drejt vendeve të tjera të BE-së përmes tranzitimit nëpër territorin e Gjermanisë”, ka thënë Aliu. Ai ka bërë me dije se gjatë takimit, ndër të tjera, diskutuan edhe mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjen nga Ministria për Digjitalizim dhe Transport e Gjermanisë në fushën e transportit, me theks të veçantë në procesin e digjitalizimit të lejeve dhe në zhvillimin e sistemit inteligjent të transportit.

BERZh-i ka investuar 113 milionë euro në Kosovë në vitin 2024

PRISHTINË, 11 SHKURT - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) njofton se ka investuar 113 milionë euro në Kosovë në vitin 2024 përmes 19 projekteve, duke tejkaluar 81 milionë euro që kishte investuar në 16 projekte në vitin 2023. Sergiy Maslitchenko, kreu i BERZh-it për Kosovën, tha se investimi në Kosovë vitin e kaluar nënvizoi përkushtim për ta mbështetur rimëkëmbjen ekonomike të vendit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. “Projektet që kemi ndërmarrë, veçanërisht në sektorin privat dhe ekonominë e gjelbër, do të

kenë një ndikim të qëndrueshëm pozitiv në jetën e qytetarëve. Ne jemi krenarë që po kontribuojmë në përparimin e Kosovës dhe presim që ta vazhdojmë mbështetjen tonë në vitet në vijim”, tha ai. Shumica e këtyre projekteve - 17 nga 19 - përfshinin investime në sektorin privat, duke mbështetur ekonominë e Kosovës. Banka u fokusua kryesisht në tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër, duke drejtuar 80 për qind të investimeve të saj në projekte të gjelbra. Në të njëjtën kohë, 11 projekte



përfshinin një komponent gjinor, duke demonstruar përkushtimin e BERZh-it për ta mbështetur barazinë gjinore në

vend. “Në vitin 2024 BERZh-i pranoi kredinë e saj më të madhe ndonjëherë në Kosovë, duke ofruar 50 milionë euro për

përmirësime të efikasitetit së energjisë deri në 400 ndërtesa publike në vend (si dhe duke siguruar një grant investimi prej 7 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian për ta bërë këtë projekt në shkallë të gjerë më të përballueshëm). Këto masa të efikasitetit së energjisë do të çojnë në kursime mesatare prej 30 deri në 50 për qind, ndërsa do t’i shkurtojnë ndjeshëm emetimet e gazeve serrë”, ka njoftuar BERZh-i.

Situata pat në shahun politik



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Maratona zgjedhore mbërriti në cak: Pasi u bënë të qarta exit-pollet, filloi të hiqet mjegulla. Realisht, exit-poli i projeksonit “Koha” ishte më i sakti dhe shumë i përafërt me rezultatet përfundimtare. Në shkrimet e mia kam parashikuar saktë renditjen e subjekteve politike sikur edhe rezultatet e PDK-së, LDK-së dhe AAK-NISMA, kurse e kam huqur bukur shumë rezultatin e LV-së. Edhe sot mendoj se LV-ja nuk e ka merituar këtë rezultat dhe se ky rezultat është pasojë e mosrritjes së pritshme të LDK-së. Nuk kam besuar se LDK-ja mbetet nën 21 për qind, minimumi sikur që kam besuar se AAK – ja duhet të fitojë minimalisht 10 për qind. Edhe për KF kam besuar se fiton prej 4 deri në 5.5 për qind. Në fillim pata besuar se mund ta kalojë pragun kurse më vonë jam ftohur nga kjo pritje për faktin se në Kosovë është një disponim antimysliman sikur edhe në botë. Për mendimin tim fituesi kryesor në këto zgjedhje është PDK-ja sepse e mori veten shpejtë ndonëse themeluesit i ka në burgun e Hagës ku po mbahen si pengje nga Gjykata Raciste Speciale, pastaj mori shumë pak vota në Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Podujevë, qendra më shumë vota. Humbës janë LDK-ja dhe LVV-ja kurse superhumbëse është Vjosa Osmani. Rezultatet janë këto që janë, i pëlqyen dikujt a jo. Po pse ndodhi kështu?

1. LV- ja në zgjedhjet e vitit 2021 mori mbi 50 për qind të votave dhe me partitë e shkrira, Guxo dhe Alternativa

kishte mundësi të arta të bëjë punë të mira, jo aq në planin politik sa në atë ekonomik dhe social. LV-ja kishte shumë pushtet për ta mbushur me ekip cilësor prandaj futi “kucën dhe macen” në hapësira institucionale për të mos lënë vakum sipas sloganit komunist se: “nga sasia del cilësia”. Të gjithë jemi dëshmitarë se çfarë cilësie solli, më mirë t’i linte bosh ato hapësira, dëmi do të ishte më i vogël. LV-ja ishte arrogante me të gjithë ata që kishin mendim ndryshe sikur që kishte sjellje sadiste ndaj opozitës. E ngufati debatin dhe e helmoi mjedisin familjar, shoqëror dhe institucional. Përçau shqiptarët në Maqedoni të Veriut, në Luginë të Preshevës, ndërsa në Shqipëri dështoi. Nuk pati investime kapitale, zhvillimi ekonomik ishte i improvizuar, ndërsa gjendja sociale po përkeqësohet dita-ditës. Veprimet në veri të Kosovës ishin të ligjshme dhe në përputhje me standardet e pushtetit lokal, por se u kundërshtuan nga ndërkombëtarët që na futën sanksionet dhe na izoluan. Albin Kurti fitoi më së shumti vota për “politikën e hekurt” në veri dhe kundërshtimit të Grenellit. Se çdo të vjen nga Grenelli, nuk e di, por se pikërisht në veri të Kosovës do të detyrohet të bëjë lëshime më të mëdha, nuk kam asnjë dyshim. Lista Serbe fitoi zgjedhjet kurse në vjeshtë pushteti lokal do t’i kalojë serbëve lokalë.

2. LDK-ja duket se vetëm ambalazhimin e ka reformuar, brendinë e ka ashtëzuar. Kjo

më së miri dëshmon pse i kanë humbur edhe bastionet që as që ka imagjinuar se mund t’i humbë. Nuk mbloodhi mend nga përgjysmimi i votave në zgjedhjet e vitit 2021, mendoi se mund të sigurojë vota me varrin e Rugovës, me “filozofinë” rugoviane duke harruar se çdo gjë ka afat skadence. Nuk dha hapësirë të mjaftueshme për kuadro të reja dhe përjashtoi nga partia themeluesit e saj. Për këtë arsye humbi Podujevën dhe kuadro me peshë politike dhe kombëtare. Nuk arriti t’i kthejë votat e kontrabanduara të LV-së nga Vojsa Osmani dhe Donika Shvarc Zeza.

3. AAK-ja jam i sigurt se më mirë do të kalonte po të garonte e vetme se e shoqëruar nga grupime politike dhe intelektuale, me emër nga e kaluara, pa të tashme dhe një të ardhme fiktive. “Ardhacakët” kanë demotivuar anëtarët e kamotshëm të AAK-së sepse i kanë rrezikuar. Nëse AAK-NISMA siguron 10 deputetë, mund të kapërdihet disi.

Koalicionet e mundshme: Të ne është me rëndësi se kush e ka pushtetin e jo kush ka më shumë deputetë. Prandaj të gjithë e lakmojnë. Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 u krijua një pat pozicion ku partia fituese nuk mund ta bëjë qeverinë e vetme, madje nëse nuk i siguron 51 deputetë nuk mund ta bëjë qeverinë as me deputetët joserbë në kohën kur LV-ja ka dhënë zotim publik se nuk e bën qeverinë me Listën Serbe.

Uroj që këtë të mos ta ketë dëgjuar Mimoza Kusari, zemlakica e Milan Radoiqiç. Lista Serbe është parti e regjistruar në Kosovë, është parti parlamentare dhe paguhet nga buxheti i shtetit. Nuk shoh asnjë shkelje ligjore apo tradhti “kombëtare kosovare” nëse LV-ja apo cilido subjekt politik bën koalicion me partinë jashtëzakonisht të disponuar miqësisht me Limoza Kularin. LVV-ja plus minoritetet mund t’i ketë minimalisht 65 - 66 deputetë, kurse opozita shqiptare 54-55 deputetë. Albin Kurti apo Cezari i LV-së ka deklaruar se më parë kalon në opozitë se që bën koalicion me PDK-në, LDK-në dhe AAK - NISMA. Nuk kanë mbetur shumë mundësi. Nëse LDK-ja bën koalicion me LV-në pamëshirshëm do të bluhej nga kjo parti. LV-ja nuk do të kishte asnjë mundësi ta bluaj PDK-në. AAK - NISMA edhe mund të bëjnë koalicion me “tradhtarët” dhe patriotët. Opozitës aktuale mbase materialisht i konvenon pushteti përmes hyrjes në koalicion, mirëpo politikisht do të dëmtohej shumë, mbase pariparueshëm. Opozita aktuale duhet të ndihmojë KM Kurti ta bëjë qeverinë pastaj të tërhiqet në opozitë. Formimi i qeverisë merr kohë, shumë varet nga bioritmi i Grenellit, Trampi nuk merret me këtë çështje. Opozita qysh tani duhet të fillojë përgatitjet për zgjedhjet lokale që mbahen këtë vit. Në shkurt të vitit 2026 edhe pozita sikur edhe opozita kanë mundësi të 100 përqindta të provokojnë

zgjedhje të parakohshme gjatë procesit të zgjedhjes së presidentit/ presidentes. Cilado qeveri që do të zgjidhej, do të kishte fare pak mundësi të bëjë punë të mira sikur që “bëri” LV-ja. Pas formimit të qeverisë, mbase me ndrikulla ndërkombëtare, vjen vera dhe pushimet e “merituara” pastaj fillon fushata për zgjedhje lokale, formimi i pushtetit lokal, pushimet e fundvitit dhe në fillim të vitit zgjedhja e presidentit/ presidentes. Lejeni Albin Kurtin të merret me Grenellin dhe Trampin, po thotë se populli e do edhe për një mandat. Asnjë politikan i përgjegjshëm nuk do të dëshironte të përballej me situatën ku Kosova është krejtësisht inferiore dhe kur nuk pyetet asgjë. Në rrethana normale, KM Kurti do të duhej të sillej përulësisht ndaj opozitës duke kërkuar të ndërtohej një konsensus kombëtar për proceset e ardhshme, shumë të vështira për Kosovën, por në rrethana kur është i rrethuar me intelektualë të profilit dhe rëndësisë ndërkombëtare, nuk ka nevojë për hajvanat e opozitës pasi paska ikur koha e hajvanatit! Merreni me mend që pastaj me këtë njeri të bëni koalicion. Albin Kurti duhet ta sqarojë opinionin se a është KM i të gjithë qytetarëve të Kosovës apo vetëm i “qytetarëve” të LV-së. Prandaj duhet të kërkojë falje publike, që nuk paraqet aspak dobësi apo ulje të autoritetit. Përkundrazi, vetëm e bënë më të pranueshëm.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zyrtare: Lindon Emërllahu, lojtar i ri i CFR Cluj

Cluj-Napoca, 11 shkurt - Klubi rumun, CFR Cluj, ka njoftuar zyrtarisht për transferimin e mesfushorit Lindon Emërllahu nga Ballkani. Disa ditë pas konfirmimit të transferimit të Emërllahut në

Rumani, tani ka ardhur edhe zyrtarizmi. Është faqja zyrtare e CFR Cluj ka njoftuar se mesfushori therandas është tashmë lojtari më i ri i tyre. "Lojtari më i mirë në Kosovë në CFR Cluj! Tani është

zyrtare. Klubet CFR 1907 Cluj dhe FC Ballkani kanë arritur marrëveshje për transferimin e mesfushorit të ri Lindon Emërllahu. Mirë se vini Lindon, dhe shumë suksese të tjera në fanellën e qershive!",

thuhet në njoftimin e CFR Cluj. Ndryshe, presidenti i klubit rumun, Nelu Varga, ka konfirmuar se për Emërllahun kanë paguar 700 mijë euro dhe 15 për qind të një transferim të ardhshëm.



Trepça dhe Bashkimi synojnë trofeun e Kupës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHKURT - Sonte (e mërkurë) zhvillohet finalja e ProCredit Kupës së Kosovës në basketboll në mes të Trepçës dhe Bashkimit. Kjo përballje pritet të jetë spektakël, duke marrë parasysh rivalitetin mes skuadrave, por edhe formën e mirë të treguar në këtë edicion. KB Trepça ka fituar shtatë herë Kupën e Kosovës, duke përfshirë edhe tri herët e fundit, derisa Bashkimi ka fituar vetëm një herë këtë trofe të rëndësishëm më 2001 dhe tash synon ta fitojë për herë të dytë. Basketbollisti i Trepçës, Dardan Kapiti, është optimist se skuadra e tij do ta

vazhdojë dominimin në garën e Kupës. "Kjo finale do të jetë shumë e rëndësishme për ne dhe qytetin e Mitrovicës. Jemi përgatitur maksimalisht dhe besojmë se do të rikthehem me trofe në qytetin e Mitrovicës. I ftoj të gjithë tifozët të vijnë të na përkrahin dhe të mos këtë incidente", ka thënë Kapiti. Për ndeshjen finale ka folur edhe basketbollisti Valon Bunjaku i Bashkimit, i cili ka deklaruar se me ndihmën e tifozëve do ta fitojë Kupën pas shumë vitesh. "Jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje që ka rendësi të madhe për klubin dhe qytetin. Për ta fituar Kupën e Kosovës pas disa vitesh, besojmë se do ta kemi përkrahjen e tifozëve dhe



bëjmë thirrje të mos këtë incidente dhe të fitojë basketbolli kosovar", ka thënë Bunjaku. Rruga drejt finales nuk ishte aspak e lehtë. Mitrovicasit në

çerekfinale eliminuan Proton Cable Prizrenin, kurse në gjysmëfinale rivalin e vjetër, Sigal Prishtinën që, edhe pse humbën ndeshjen e parë, u rikthyen në atë të dytë për ta

siguruar biletën për finale. Bashkimi në çerekfinale eliminoi Borën, derisa në gjysmëfinale Vëllaznimin. Në ndeshjen e parë pësuan nga kuqezinjtë, derisa në përballjen e dytë arritën rikthimin për ta siguruar finalen. Biletat për ndeshjen finale të ProCredit Kupës do të shiten për klubet finaliste, Trepçën dhe Bashkimin. Gjithsej do të ndahen nga 750 bileta për Klubin e Trepçës dhe 750 për Bashkimin. Biletat e thjeshta kushtojnë 5 euro, kurse ato VIP nën kosh kushtojnë 15 euro, që janë në sasi më të vogël dhe menaxhohen nga klubet finaliste. Ndeshja finale zhvillohet më 12 shkurt në Prishtinë nga ora 19:00.

Haxhihamza, 'Ylli i javës' në Superligë: Synojmë daljen në Evropë



Gjilan, 11 shkurt - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 19 në Albi Mall Superligë i është dhënë portierit të SC Gjilanit, Kenan Haxhihamza. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Naim Kodraliu, Denis Isaja dhe Xhavit Mehmetit. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e nëntëmbëdhjetë t'i takojë Kenan Haxhihamzës, i cili me pritjet e tij ishte vendimtar në fitoren e skuadrës së tij kundër Llapit në transfertë

(0:1), duke arkëtuar tri pikë shumë të rëndësishme për Gjilanin. Pasi mori këtë çmim, Haxhihamza u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Është e rëndësishme që kemi fituar ndeshjen e parë sepse është një hap i rëndësishëm për hapjen e sezonit. Ky është një rezultat i punës që kemi bërë në fazën përgatitore. Sa i përket kundërshtarit, ne jemi takuar edhe dy herë më parë me Llapin në këtë kampionat dhe kemi pasur rezultate pozitive. I njohim pikat e dobëta dhe të forta të tyre. Pas transferimeve, kemi krijuar një grup shumë më të kualitetshëm dhe na mbetet

ta bëjmë punën në fushë për të sjellë rezultate dhe të dalim sa më shpejt në lojën që kërkon stafi teknik. Na ka ndihmuar shumë fakti që jemi bashkë që 6 muaj". "Synimi i klubit është minimumi dalja në Evropë. Ne jemi ende në Kupë dhe do të luftojmë edhe për të fituar këtë trofe dhe për ta përmbyllur mirë sezonin. Çmimin ua dedikoj të gjithë atyre që kanë investuar në mua që nga dita e parë, gjithashtu bashkëlojtarëve të cilët kanë derdhur djersë që rezultati i ndeshjes të mbrohet", ka deklaruar Haxhihamza për faqen zyrtare të FFK-së.

Ronaldo vazhdon kontratën me Al-Nassrin

Riyadh, 11 shkurt - Cristiano Ronaldo ka rënë dakord me klubin saudit Al-Nassr për ta zgjatur kontratën e tij edhe me një sezon deri në qershor të vitit 2026. Dy palët kanë arritur një marrëveshje "e

cila, megjithatë, ende nuk është nënshkruar. Njoftimi zyrtar do të bëhet në ditët në vijim. Ronaldo, i cili mbushi 40 vjeç javën e kaluar, nënshkroi një marrëveshje dyvjeçare e gjysmë me Al-Nassrin në

fund të dhjetorit 2022, pas Kupës së Botës në Katar, duke u bërë emri i parë i madh në futboll që iu bashkua ligës saudite. Ai ka luajtur 90 ndeshje për Al-Nassrin, duke shënuar 82 gola dhe duke dhënë 19

asistime. Sipas renditjes së hartuar nga revista amerikane Forbes, në vitin 2023 ai ishte sportisti më i paguar në botë me 136 milionë dollarë, nga të cilat 46 milionë vinin vetëm nga paga.




Antonelli: Emocionuese të garosh në Formula 1, e di që e gjithë Italia pret shumë prej meje

BOLOGNA, 11 SHKURT - Pas tre sezonesh pa një pilot italian në Formula 1, tashmë do të jetë debutuesi Kimi Antonelli ai që do ta mbajë lart “tringjyrëshin” këtë sezon. Piloti 18-vjeçar do të garojë për Mercedesin, ku do ta zërë vendin e shtatë herë

kampionit të botës, Lewis Hamilton. Ndërkohë që, një fitore e një piloti italian në Formula 1 mungon që nga viti 2009 (Jarno Trulli me Toyota). Ndoshta Antonelli mund të jetë në gjendje ta thyejë këtë tabu 16-vjeçare. “Ka shumë pritshmëri

përpara këtij sezoni”, ka thënë Antonelli, që më tej shtoi: “Sigurisht që ndiej mjaft përgjegjësi sepse e di që kam gjithë Italinë pas, që pret shumë nga unë. Të gjithë presin që unë të jem i suksesshëm, veçanërisht pasi do të garoj për një Mercedes.

E gjithë kjo është shumë emocionuese. Mezi pres të nisë botërori 2025 dhe, mbi të gjitha, mezi pres garën në shtëpinë time, në Imola (18 maj). Do të doja të shihja kaq shumë italianë që brohorasin për mua”, ka deklaruar Antonelli.



Muriqi: Marr përgjegjësitë si sulmues veteran, ja ku gabuam

MALLORCA, 11 SHKURT - Vedat Muriqi shprehu pakënaqësinë e tij pas barazimit 1-1 me Osasunan. Sulmuesi shënoi një gol, duke i dhënë fund një periudhe 68-ditore pa shënuar që nga goli i fundit më 3 dhjetor. Ky gol i dha fund një periudhe prej 568 minutash pa gola për ekipin e tij. Megjithatë, gëzimi i tij u venit nga barazimi i ardhur nga Enzo Boyomo. Aktualisht Mallorca ndodhet e 10-ta në tabelë dhe mbetet e dyta nga fundi në gjysmën e dytë të këtij sezoni për nga rezultatet, duke e zgatur serinë e saj pa fitore. Muriqi përfaqëson vështirësitë aktuale të Mallorcas. I njohur si “Pirati”, ai vazhdon të luftojë për gola, por është larg formës së tij më të mirë. Edhe pse fitoi dhe realizoi një 11-metërs për t'i dhënë Mallorcas epërsinë e parë në një ndeshje këtë vit, kjo nuk ishte e mjaftueshme për ta siguruar fitoren. “Po kaloj ndjenja të përziera, sepse pas kaq shumë kohësh shënova dhe ishim kaq afër një fitoreje. Por,



ky është futbollit, e dinim që ata ishin një ekip i fortë dhe duhet të jemi gjithmonë të vëmendshëm. Doja shumë ta thyenim serinë e keqe dhe shpresojmë ta bëjmë këtë kundër Las Palmasit. Duhet t'i marrim tri pikë. Nuk mund të vazhdojmë kështu. E dimë që nuk po bëjmë mirë dhe duhet ta rimarrim veten”, ka thënë Muriqi.

Si sulmues, Muriqi e njeh peshën e përgjegjësisë së tij: “Statistikat e mia flasin vetë.

Nuk kam shënuar shumë gola në tre muaj. Ekipi vuan kur nuk shënojmë dhe kjo është përgjegjësi e sulmuesit. Si një nga më të vjetrit në ekip, duhet ta marr përsipër fajin dhe ta reflektoj kritikun mbi performancën time për të sjellë gëzim përsëri për tifozët”. Muriqi, gjithashtu, theksoi gabimin taktik të ekipit pas marrjes së epërsisë. “Ne u tërhoqëm më shumë sesa duhet, që është e kuptueshme kur je kaq afër fitores ndaj Osasunës. Megjithatë, ata na shtynë mjaftueshëm për të na bërë të pendoheshim që nuk bëmë faullet që duhej për të marrë frymë. Kërkoj ndjesë nga mbështetësit tanë. Jam i lumtur për golin tim të parë të vitit, por duhet të fitojmë me çdo çmim”, ka përfunduar Muriqi. Me golin e tij kundër Osasunës, Muriqi tani ka katër gola këtë sezon, duke konsoliduar pozitën si shënuesi i dytë më i mirë i Mallorcas, pas Cyle Larin, i cili ka shënuar pesë herë.

Oklahoma e Clevelandi komandojnë dy konferencat



CLEVELAND, 11 SHKURT - Kryesuesit e Clevelandit fituan me rezultat 128-107 ndaj Minnesotas, në një ndeshje pa shumë histori. Edhe pse Edwardsi realizoi 44 pikë për miqtë, nuk mjaftuan për të fituar. Mobley me 28 pikë e Mitchell me 23 pikë u dalluan për Cavaliersin. Fitore të

rëndësishme korri skuadra e Golden States, që falë 38 pikëve të Stephen Curryt, mundi me shifrat 125-111 Milwaukeeen jashtë fushës. Pa problem fitoi edhe Denveri, që mundi thellë me rezultat 146-117 Portlandin, ndeshje ku u dallua Nikola Jokiq me 40 pikë. Debutim me fitore i

REZULTATET	
Cleveland - Minnesota	128-107
Orlando - Atlanta	106-112
Washington - San Antonio	121-131
Brooklyn - Charlotte	97-89
Miami - Boston	85-103
Milwaukee - Golden State	111-125
Oklahoma - New Orleans	137-101
Dallas - Sacramento	128-129
Denver - Portland	146-117
Lakers - Utah Jazz	132-113

Luka Donqiqit te Lakersi, që mundi me shifrat 132-113 Utah Jazzin, ndeshje ku shtatë lojtarë të ekipit kalifornian realizuan mbi 10 pikë. Në Përfundim kryeson ekipi i Oklahomas, që mundi me rezultat 137-101 New Orleansin (Alexander Shai 31 pikë).

SHKURT

Hoxha në ekipin e javës në Kroaci

Sulmuesi i krahut, Arbër Hoxha, ka zënë vend në formacionin më të mirë të xhiros së 21-të në kampionatin e Kroacisë. Hoxha pati paraqitje fantastike në fitoren e Dinamo Zagrebit 3:0 në shtëpi kundër Shibenikut. Edhe pse nuk ishte startues, Hoxha ishte ndër më të merituarit për pikët e plota të ekipit të trajnerit Fabio Cannavaro. Hoxha u inkadrua në lojë në minutën e 59, ndërsa shënoi një gol dhe asistoi në një tjetër, për të cilën u vlerësua me notën 8.2. 26-vjeçari deri më tani këtë sezon ka shënuar 6 gola dhe ka bërë 4 asistime në të gjitha garat, kurse me ekipin e madh nga Kroacia ka kontratë deri në verën e vitit 2027. Hoxha që ka edhe 11 paraqitje me Kombëtaren e Shqipërisë, është pjesë e Dinamo Zagrebit që prej vitit 2024 kur iu bashkua nga Slaven Belupo.

Gavi: Njerëzit menduan se nuk do të rikthehemi, por ne duam të fitojmë La Ligën

Gavi, mesfushori i Barcelonës, foli për faqen zyrtare të klubit katalanas pas fitores 4-1 ndaj Sevilas në kampionat. Një fitore që ka afruar skuadrën “blaugrana” me dy skuadrat e Madridit në krye të renditjes. Mesfushori ka shpjeguar se Barcelona ka qenë gjithmonë në luftë për ta fituar La Ligën: “E kam thënë tashmë që kampionati është shumë i gjatë. Njerëzit mendonin se ne nuk do të mbërrinim. Jemi dy pikë prapa dhe jemi ende shumë larg fundit”. “Duhet të vazhdojmë në këtë mënyrë dhe t'i fitojmë të gjitha ndeshjet që kanë mbetur për ta fituar këtë kampionat. Të fitojmë titullin, kjo është ajo që duam më shumë të gjithë”, u shpreh Gavi. Duket se edhe Gavi mbështet trajnerin Hansi Flick që, gjithashtu, ka deklaruar më herët se pëlqen më shumë titullin në La Liga sesa triumfin në Ligën e Kampionëve, ku Barcelona është kualifikuar në turin tjetër.

Nainggolan: Më trajtojnë si Eskobari, por unë nuk kam lidhje me drogën

Radja Nainggolan ka thyer heshtjen dy javë pas arrestimit në Belgjikë. Ish-mesfushori i Romës dhe Interit ka hedhur dritë mbi situatën e tij pasi u implikua në një hetim për trafikun e kokainës që përfshin 15 persona të tjerë. “Marrja në pyetje zgjati katër orë dhe ishte ora 18.00, prandaj ishte tepër vonë për një gjykatës hetues”, ka shpjeguar Nainggolan për gazetën e përditshme “Het Laatste Nieuws”. “Kështu që ata vendosën të më detyronin të kaloja natën në qeli”, ka shtuar ai. Radja, që aktualisht ka kontratë me Lokorenin në Kategorinë e Dytë të Belgjikës, nuk e fsheh hidhërimin për këtë ngjarje. “Burgu ishte një përvojë shumë e çuditshme, që nuk do të doja ta ripërfetoja kurrë. Lajmi u përhap shpejt. Dukej se e kishin mbyllur Pablo Eskobarin... Unë nuk kam lidhje me ato raste droge dhe në fakt nuk më bënë asnjë pyetje për këtë temë. Marrja në pyetje u fokusua kryesisht në marrëdhënien time me atë person”, ka deklaruar Nainggolan.

Ende nuk ka rinovuar me Realin, PSG-ja synon transferimin e Viniciusit

PSG-ja ka nisur bisedimet për transferimin e Vinicius Junior pasi ka parë që ylli i Real Madridit refuzoi ofertën për rinovimin e kontratës Paris Saint-Germain ka

zhvilluar biseda me përfaqësuesit e Vinicius Junior. Raportet sugjerojnë se negociatat e kontratës mes Real Madridit dhe Vinicius u zhvilluan dy javë më parë,

por nuk u arrit marrëveshje. Sulmuesi brazilian e hodhi poshtë propozimin pasi priste kushte më të mira financiare, duke besuar se oferta e klubit nuk pasqyron

vlerën e tij. Zyrtarët e Arabisë Saudite dyshohet se kanë paraqitur një kontratë marramendëse prej një miliard eurosh gjatë pesë viteve. Edhe pse Viniciusi

mbetet nën kontratë në Santiago Bernabeu deri në qershor 2027, përfaqësuesit e tij e kanë bërë të qartë se qëndrimi nuk është një garanci në Madrid.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

